



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.990/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Ardian Nushi kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Gjakovës, nga Subjekti Politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, me seli në Gjakovë, dega në Komunën e Gjakovës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.990/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Ardian Nushi kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Gjakovës, nga Subjekti Politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, me seli në Gjakovë, dega në Komunën e Gjakovës, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimin me nr. 0224C/02R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.990/2021 të paraqitur nga Ardian Nushi kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Gjakovës, nga Subjekti Politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, me seli në Gjakovë, dega në Komunën e Gjakovës, me të cilën pretendon se në vendvotimin 0224C/02R, nuk janë bartur 76 vota të kandidatëve nga kryesuesja e këtij vendvotimi.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Ardian Nushi kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Gjakovës, nga Subjekti Politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, me seli në Gjakovë, dega në Komunën e Gjakovës, me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimin 0224C/02R, është i pa bazuar. Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të

LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.990/2021 më datën 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.